

URDHËR
Nr. 167, datë 3.7.2020

**PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR
TË KONTABILITETIT NR. 1
“PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE” (SNK 1)**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019 ‘Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit’”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e disa ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 1, “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” (SNK 1).
2. Ndryshimet e SNK 1, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 janarin 2022. Lejohet zbatimi përpara datës efektive, por njësia ekonomike duhet të japë shënime shpjeguese për këtë fakt.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurta ose afatgjata
Ndryshime në SNK 1

Ndryshime në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*

Janë ndryshuar paragrafët 69, 73, 74 dhe 76. Janë shtuar paragrafët 72A, 75A, 76A, 76B dhe 139U. Paragrafi 139D është fshirë. Para paragrafëve 70, 71, 72A dhe 76A janë shtuar tituj. Paragrafët 70, 71, 72 dhe 75 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Struktura dhe përmbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar

Detyrimet afatshkurtra

69 Një njësi ekonomike do të klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur:

- (a) pret të shlyejë detyrimin gjatë ciklit normal të shfrytëzimit;
- (b) e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtare;
- (c) detyrimi duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit; ose
- (d) nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar të drejtë në fund të periudhës raportuese për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit ~~(shih paragrafin 73). Kushtet e një detyrimi që mund të sjellin shlyerjen e tij nga emetuesi në instrumente kapitali, nëse pala tjetër e ushtron këtë opsion, nuk ndikojnë ndasifikimin e tij.~~

Njësia ekonomike do të klasifikojë të gjitha detyrimet e tjera si afatgjata.

Cikël normal shfrytëzimi (paragrafi 69(a))

70 Disa detyrime afatshkurtra, si p.sh. llogaritë e pagueshme tregtare dhe disa detyrime të konstatuara për punonjësit dhe kosto të tjera të shfrytëzimit, janë pjesë e kapitalit punues të përdorur në ciklin normal të shfrytëzimit të njësive ekonomike. Zëra të tillë shfrytëzimi klasifikohen si detyrime afatshkurtra edhe pse mund të duhet të shlyhen përtej dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Për klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve të një njësie ekonomike zbatohet i njëjti cikël normal shfrytëzimi. Nëse cikli normal i shfrytëzimit të njësive ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, supozohet se ai zgjat dymbëdhjetë muaj.

I mbajtur kryesisht për tregtim (paragrafi 69(b)) ose duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve (paragrafi 69(c))

71 Detyrimet e tjera afatshkurtra që nuk janë shlyer gjatë ciklit normal të shfrytëzimit por që duhet të shlyhen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit ose që mbahen kryesisht për qëllime tregtare. Shembuj janë disa detyrime financiare që plotësojnë përkufizimin si të mbajtura për tregtim në SNRF 9, overdraftet (llogaritë e zbuluara) bankare dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve afatgjata financiare, dividendët e pagueshëm, tatimi mbi të ardhurat dhe të pagueshme të tjera jo tregtare. Detyrimet financiare që sigurojnë financim mbi një bazë afatgjatë (d.m.th. nuk janë pjesë e kapitalit qarkullues të përdorur gjatë ciklit normal të shfrytëzimit të njësive ekonomike) dhe që nuk kërkohet të shlyhen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit, janë detyrime afatgjata, objekt i paragrafëve 74 dhe 75.

72 Një njësi ekonomike klasifikon detyrimet e saj financiare si afatshkurtra kur ato kërkohen për t'u shlyer brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit edhe nëse:

- (a) afati fillestar ishte për një periudhë më të gjatë se dymbëdhjetë muaj; dhe

- (b) një marrëveshje për rifinancimin ose riskedulimin e pagesave në baza afatgjata përfundon pas datës së raportimit dhe para se të autorizohet nxjerrja e pasqyrave financiare.

E drejta për ta shtyrë shlyerjen për të paktën dymbëdhjetë muaj (paragrafi 69(d))

- 72A E drejta e një njësie ekonomike për ta shtyrë shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës raportuese duhet të jetë thelbësore dhe duhet të ekzistojë në fund të periudhës së raportimit, siç ilustron në paragrafët 73–75. Nëse e drejta për të shtyrë shlyerjen është objekt i pajtueshmërisë me kushte specifike nga ana e njësisë ekonomike, e drejta ekziston në fund të periudhës së raportimit vetëm nëse njësia ekonomike është në pajtim me ato kushte në fund të asaj periudhe. Njësia ekonomike duhet të jetë në pajtim me kushtet në fund të periudhës së raportimit edhe nëse huadhënësi nuk e teston pajtueshmërinë e tyre deri në një datë të mëvonshme.
- 73 ~~Nëse një njësi ekonomike pret dhe ka mundësinë të drejtë, në fund të periudhës së raportimit, që të rifinancojë ose të shtyjë një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës raportuese për një hua ekzistuese, ajo e klasifikon detyrimin si afatgjatë edhe nëse ndryshe do t'i duhej ta shlyejë brenda një periudhe më të shkurtër. Megjithatë, nëse rifinancimi ose shtyrja e detyrimit nuk varet nga njësia ekonomike (për shembull nuk ekziston një marrëveshje rifinancimi) Njësia ekonomike nuk e ka një të drejtë të tillë, mundësia e rifinancimit nuk merret në konsideratë dhe detyrimi klasifikohet si afatshkurtër.~~
- 74 Nëse një njësi ekonomike shkel një dispozitë kusht lidhur me një marrëveshje huaje afatgjatë në ose përpara fundit të periudhës raportuese, me efekte që detyrimi bëhet i pagueshëm në të parë, detyrimi klasifikohet si afatshkurtër edhe nëse huadhënësi ka rënë dakord pas periudhës së raportimit dhe para autorizimit për publikimin e pasqyrave financiare, të mos kërkojë shlyerjen e huasë si pasojë e shkeljes. Njësia ekonomike e klasifikon detyrimin si afatshkurtër, sepse në fund të periudhës së raportimit ajo nuk ka ndonjë të drejtë të pakushtëzuar të drejtë të shtyjë shlyerjen e tij për të paktën dymbëdhjetë muaj pas asaj date.
- 75 Megjithatë detyrimi klasifikohet si afatgjatë nëse huadhënësi ka rënë dakord që në fund të periudhës raportuese të ofrojë një periudhë faljeje, e cila përfundon të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit dhe brenda të cilës njësia ekonomike mund të korrigjojë shkeljen dhe gjatë së cilës huadhënësi nuk mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme.
- 75A Klasifikimi i një detyrimi nuk ndikohet nga mundësia që njësia ekonomike do të ushtrojë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit. Nëse një detyrim plotëson kriterin në paragrafin 69 për t'u klasifikuar si afatgjatë, ai klasifikohet si afatgjatë edhe nëse drejtimi synon ose pret që njësia ekonomike ta shlyejë detyrimin brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit, ose edhe nëse njësia ekonomike e shlyen detyrimin pas periudhës së raportimit por para datës së autorizimit për publikim të pasqyrave financiare. Megjithatë, në të dy rrethanat, njësia ekonomike mund të ketë nevojë të japë informacion shpjegues mbi kohën e shlyerjes për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të kuptuarit e ndikimit të detyrimit në pozicionin financiar të njësisë ekonomike (shih paragrafët 17(c) dhe 76(d)).
- 76 ~~Lidhur me huatë e klasifikuara si detyrime afatshkurtra, nëse Një ngjarjet vijuese ndodhin ndërmjet fundit të periudhës së raportimit dhe datës së autorizimit për publikim të pasqyrave financiare, për këto ngjarje jepet informacion shpjegues si ngjarje jo-rregulluese në përputhje me SNK 10 Ngjarje pas periudhës së raportimit.~~
- (a) rifinancimi mbi një bazë afatgjatë i një detyrimi klasifikohet si afatshkurtër (shih paragrafin 72);
- (b) korrigjimi i një shkeljeje në një marrëveshje afatgjatë huaje klasifikohet si afatshkurtër (shih paragrafin 74); dhe
- (c) marrja nga huadhënësi e një periudhe faljeje për të korrigjuar një shkelje të një marrëveshjeje afatgjatë huaje që përfundon të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit financiar klasifikohet si afatshkurtër (shih paragrafin 75); dhe
- (d) shlyerja e një detyrimi klasifikohet si afatgjatë (shih paragrafin 75A).

Shlyerja (paragrafët 69(a), 69(c) dhe 69(d))

- 76A Me qëllim klasifikimin e një detyrimi si afatshkurtër ose afatgjatë, shlyerja i referohet një transferimi tek pala tjetër që sjell eliminimin e detyrimit. Transferimi mund të jetë:
- (a) në mjete monetare ose në burime të tjera ekonomike—për shembull, mallra ose shërbime; ose
- (b) në instrumente të kapitalit të vet të njësisë ekonomike, me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 76B.

76B Kushtet e një detyrimi që shpesh mundësojnë që pasës t'ijetër, siç thuhet shpesh, të tregojnë të dhëna të transferuar instrumente të kapitalit të cilat të njëjtë ekonomike me të cilat në klasifikimin e tillë si afatshkurorë apo afatgjatë nëse nënkuptojnë të klasifikimit mundësojnë që një instrument kapitali, duke e shprehur kështu, në detyrimin që të përfaqësojë kapitalin dhe instrumenti financiar të përfaqësojë zotësinë e SNF.

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

139D [Eshirë]

139L *Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurorë ose afatgjatë* i publikuar në janar 2020 ndryshoi paragrafët 69, 73, 74 dhe 75 si dhe shënimi paragrafët 75A—75D dhe 76B dhe 76C. Në muajin shkurtor, do të shfaqet këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që filluan në datën 1 janar 2022 ose pas kësaj date në mënyrë retrospektive në përputhje me SHK 8. Të gjithë shënimi raportues kësaj date. Nëse një muaj ekonomik i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.